



FEDERATA SPORTIVE E PUNËTORËVE TË KOSOVËS

Në bazë të nenit 6.8. e Statutit të FSPK, Komiteti Ekzekutiv në mbledhjen e vet të mbajtur më 24.04.2023, me propozim të Komisarit të garave miratoi:

PROPOZICIONET E GARAVE për disiplinën e basketbollit, Liga e meshkujve, për edicionin 2023

Neni 1

Me këto propozicione përcaktohet mënyra dhe kushtet e zhvillimit të garave në Ligë për meshkuj, në basketboll, për vitin garues 2023.

Neni 2

Garat i udhëheq Komisari i garave – **KG**, të cilin e zgjedh Komiteti Ekzekutiv i FSPK-ës. Komisari i garave zgjidhet për çdo vit garues, dhe për punën e tij i përgjigjet Komiteti Ekzekutiv.

Selia e KG-ve është në Prishtinë, në lokalet e FSPK-ës, _____, telefon: +381/38/____-____; mob: +383/49/503-901; fax: +381/38/____-____; interneti: **WWW._____**; e-maili: **federatasportive@gmail.com**

Të drejtat dhe obligimet e Komisarit të garave janë:

- Në mënyrë të drejtpërdrejt udhëheq me garat që i organizon dhe mbanë Federata, duke u bazuar në aktet normative në fuqi të FSPK-ës,
- Përcakton listën e personave zyrtarë (gjyqtarë, vëzhgues, evidentues), paraprakisht të aprovuar nga Komiteti Ekzekutiv i FSPK-ës;
- Regjistron ndeshjet dhe rezultatet e tyre;
- Propozon mbi të gjitha çështjet lidhur me organizimin e garave;
- Propozon për të gjitha dënimet e parapara me aktet normative;
- Udhëheq procedurën disiplinore dhe propozon shqiptimin e dënime klubeve dhe zyrtarëve;
- Nxjerr rezultatet zyrtare pas çdo xhiroje apo seance dhe atë iu dërgon me postë elektronike:
 - Të gjitha klubeve pjesëmarrëse në gara;
 - Kryetarit të FSPK-ës dhe gjithë anëtarëve të Komiteti Ekzekutiv;
 - Pranon ankesat e klubeve dhe propozon vendime me arsyetimin e vendimeve të shqiptuara dhe ja përcjellë në shqyrtim dhe për vendimmarrje të mëtejme Komiteti Ekzekutiv të FSPK-ës;
 - Bënë të gjitha përgatitjet për sezonin e ardhshëm të garave dhe i propozon Komiteti Ekzekutiv;
 - Kryen edhe punë të tjera me qëllim të mbarëvajtjes së suksesshme të garave.

Neni 3

Regjistri përfundimtar i pjesëmarrësve të garave për vitin garues 2023, është definuar dhe përbëhet prej 8 klubeve:

1. IPKO
2. RBKO
3. TEB
4. BKT
5. ODA E AVOKATËVE
6. MERIDIAN
7. DUKAGJINI GROUP dhe
8. SHOQATA E STOMATOLOGEVE

Neni 4

Garat e kampionatit për vitin 2023, do të zhvillohen sistemit “ardhje-vajtje”, ku secili do të takohen me secilin.



FEDERATA SPORTIVE E PUNËTORËVE TË KOSOVËS

Neni 5

Përveç garave kampionate, do të organizohen edhe garat për kupë.

Neni 6

Garat në Ligë zhvillohen sipas rregullave të lojës, propozicioneve të lojës të propozuara nga Komesari i garave dhe të aprovuara nga Komiteti Ekzekutiv i Federatës.

Regjistri bazë i ekipeve do të ketë 12 lojtarë. Ekipeve do të luajnë me 5 lojtarë.

Neni 7

Mënyra e ndarjes së pikëve dhe përcaktimi i klasifikimit të skuadrave, bëhet sipas rregullave zyrtare të lojës në FIBA. Kjo don të thotë që rezultatet e ndeshjeve dhe numri i pikëve, do të vlerësohen në këtë mënyrë:

- Skuadrës që e ka fituar ndeshjen, i takojnë 2 (dy) pikë.
- Skuadrës që e ka humbur ndeshjen, i takon 1 (një) pikë.
- Skuadra që pa arsye nuk paraqitet për zhvillim të ndeshjes, humb ndeshjen me rezultat zyrtar (0:20) dhe i takon 0 (zero) pikë.
- Skuadra që konstatohet se është fajtores për ndërprerjen e ndeshjes, e humb ndeshjen me rezultat zyrtar (0:20) dhe i takon zero (0) pikë.
- Skuadra që aktivizon lojtarin e licencuar në ndonjë skuadër tjetër, e humb ndeshjen me rezultat zyrtar (0:20) dhe i takojnë 0 (zero) pikë. Nëse përsëritet i njëjti veprim, skuadra largohet nga garat e mëtejme.
- Skuadra që është pezulluar, ose paraqitet në ndeshje me lojtarin që nuk është i regjistruar në këtë skuadër, është i pezulluar ose është në vuajtje të dënimit, e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 0:20, dhe i takon 0 (zero) pikë.
- Nëse një skuadër në këtë mënyrë i humb 2 (dy) ndeshje, automatikisht largohet nga garat.
- Skuadra që pa arsye e braktisë fushën para përfundimit të lojës në pjesën e rregullt të garave (me përjashtim të "Play-off"), e humb ndeshjen me rezultat zyrtar (0:20), i takon 0 (zero) pikë dhe dënohet me 100 euro, me 1 (një) deri 2 (dy) ndeshje moslojë ose me suspendim nga garat.
- Skuadra që konstatohet se është fajtores për ndërprerjen e ndeshjes gjysmëfinale apo finale në "Play-off", automatikisht diskualifikohet nga garat e mëtejme.
- Skuadra që konstatohet se është fajtores për ndërprerjen e ndeshjes finale në Play-off, e humb ndeshjen me rezultat zyrtar (0:20).
- Në qoftë se skuadra gjatë lojës mbetet me më pak se 2 (dy) lojtarë në fushë, e humb ndeshjen për shkak të mospërfundimit të lojës. Në qoftë se skuadra, e cila në këtë mënyrë e fiton ndeshjen por, nuk udhëheq në rezultat, atëherë ndeshja regjistrohet me rezultat 2:0 në të mirë të saj. Në qoftë se skuadra, e cila në këtë mënyrë e fiton ndeshjen por, udhëheq në rezultat, atëherë rezultati i momentit të ndërprerjes së ndeshjes mbetet i vlefshëm. Skuadra që e humb ndeshjen në këtë mënyrë, e fiton një pikë.
- Në qoftë se ekipi i suspenduar ka zhvilluar më pak se 51 për qind të ndeshjeve, rezultatet e saja anulohen, kurse në qoftë se ka zhvilluar 50% +1 ndeshje, rezultatet e ndeshjeve të pazhvilluara regjistrohen me rezultat zyrtar 2:0 në të mirë të kundërshtarëve.
- Ekipi që gjatë një kampionati i humb tri ndeshje me rezultat zyrtar (0:20), automatikisht e humb statusin e anëtarit garues për atë stinor të garave në Ligë.

Neni 8

Ndeshjet e pjesës së kampionatit para "Play Off", do të zgjasin 4 x 7 minuta, me ndalje të kohës gjatë dy (2) minutave të fundit të ndeshjes përkatësisht të çerekut të katër (4) të lojës (topi jashtë lojës, ekzekutimi i gjuajtjeve të lira, time out, etj.).



FEDERATA SPORTIVE E PUNËTORËVE TË KOSOVËS

Neni 9

Në palestrat sportive ku zhvillohen ndeshjet, është e obliguar të gjendet dhe të funksionojë semafori digjital, i cili dirigjohet nga tavolina e gjyqtarisë. Semafori digjital duhet të tregoj kohën, rezultatin, numrin e gabimeve të lojtarëve dhe numrin e gabimeve të skuadrave.

Sipër tabelës së koshit, duhet të vendoset aparatura për matjen e 24-sekondëshit.

Neni 10

Renditja në tabelën e klasifikimit bëhet mbi bazë të pikëve të fituara. Nëse dy apo më shumë ekipe kanë numrin e njëjtë të pikëve, renditja në tabelë, përcaktohet në bazë të kosh-diferences më të mirë. Nëse edhe kosh-diferenca është e njëjtë, renditja do të bëhet në bazë të pikëve të fituara në duele në mes të atyre dy ekipeve.

Neni 11

Tërheqja e shortit për zhvillimin e garave bëhet së paku 7 (shtatë) ditë para fillimit të garave, në praninë e përfaqësuesve të klubeve. Në mungesë të ndonjë përfaqësuesi, Komisari i garave e bën tërheqjen e shortit në prani të përfaqësuesve të ekipeve tjera. Komisari mund të bën hedhjen e shortit edhe pa prani të përfaqësuesve të klubeve por, me autorizim nga të njëjtit. Radha për tërheqjen e shortit, do të bëhet sipas marrëveshjes së përfaqësuesve të institucioneve/kompanive (klubeve). Nëse nuk arrihet marrëveshja, renditja e klubeve në tabelën e klasifikimit, do të bëhet sipas alfabetit.

Neni 12

Orarin e zhvillimit të ndeshjeve e përpilon Komisari i garave (KG), kurse e miraton Komiteti Ekzekutiv.

Neni 13

Komisari i garave, ndeshjet do t'i regjistroj me rezultat zyrtar 20:0 në bazë të procesverbalit dhe deklaratave të personave zyrtar në këto raste:

- Nëse cilido nga ekipet nuk ka udhëtuar për zhvillim të lojës dhe për këtë nuk e ka njoftuar me shkrim KG-ve me kohë (së paku 48 orë), për pamundësinë e pjesëmarrjes në lojën e paraparë;
- Nëse ekipi është paraqitur me lojtarë që nuk janë të regjistruar në mënyrë të rregullt;
- Nëse ekipi paraqitet me lojtarë të cilëve u është ndërprerë marrëdhënja e punës në organizatë;
- Nëse ekipi e dorëzon ndeshjen ose ndeshja nuk zhvillohet me fajin e tij;
- Nëse ekipi e lëshon fushën ose pamundëson vazhdimin e lojës së filluar;
- Nëse ndeshja ndërpritet, për shkak të sulmit fizik ndaj personave zyrtarë apo ekipit kundërshtar.

Neni 14

Ndërprerja e ndeshjes mund të jetë e përkohshme apo përfundimtare.

a) Ndeshja mund të ndërpritet përkohësisht:

- Për shkak të acarit, nxehtësisë së madhe, tymit, frymës, ujit, territ – ndriçimi joadekuat, përkatësisht kur fusha fiton ato karakteristika ku pamundësohet kontrolli ndaj topit,
- Për shkak të sjelljes së pahijshme dhe huligane eventuale të shikuesve;
- Për shkak të konfliktit në mes lojtarëve, trajnerëve dhe personave zyrtarë të ekipeve;

Në rastet kur loja ndërpritet përkohësisht, për shkak të acarit, nxehtësisë, territ, frymës, ujit etj., ndërprerja zgjatë aq sa zgjatë ajo situatë. Pas kalimit të kësaj situatë, ndeshja e re do të fillojë, përkatësisht do të vazhdojë prej momentit të ndërprerjes, varësisht nga vendimi i zyrtarëve. Ndeshja e ndërprerë përkohësisht duhet të zhvillohet brenda 48 orëve, duke filluar nga momenti i ndërprerjes ose sipas vendimit të Komisarit të garave.



FEDERATA SPORTIVE E PUNËTORËVE TË KOSOVËS

b) Ndeshja mund të ndërpritet përfundimisht:

- Për shkak të sulmit në personat zyrtar: gjyqtarë, vëzhgues, evidentues, lojtarë, trajner;
- Kur janë cenuar rregullat e lojës deri në atë masë, ku gjyqtarët përkundër masave të ndërmarra nuk mund ta përfundojnë ndeshjen;
- Para marrjes së vendimit për ndërprerjen e ndeshjes deri në fund, evidentuesi dhe gjyqtarët janë të obliguar të kërkojnë nga ekipet apo organizatori, të:
 - evitojnë mangësitë organizative të ndeshjes, kur ndërprerja është pasojë e organizimit të dobët,
 - t'i vënë dhe respektojnë rregullat e lojës në fushë,
 - t'i zbrazë tribunat apo pjesërisht ti largoi shikuesit nga njëra anë e fushes - palestrës,

Nëse edhe pas masave të ndërmarra nuk është kthyer rendi në fushë, atëherë gjyqtarët e ndërpresin lojën. Tek ndeshjet e ndërprera përfundimisht, nuk ka vazhdim të lojës.

Neni 15

Ndeshjet preferohet të zhvillohen gjatë vikendeve (e shtune - e diele), por nëse anëtarëve iu përshtatet ndonjë orar tjetër, ato mund të zhvillohen edhe ditëve të punës, sipas propozimit të KG-ve, të miratuar nga Komiteti Ekzekutiv.

Propozimi i KG-ve duhet të bazohet në disa faktorë, sic janë:

- Kërkesat e klubeve (institucioneve/kompanive);
- Mundësitë e shfrytëzimit të fushave/palestrave;
- Mundësitë e sigurimit të gjyqtarëve etj.

Komesari mund të shtyjë terminin e zhvillimit të ndeshjes/ndeshjeve, me kërkesë të njërit ekip, nëse kërkesa paraqitet së paku 48 orë më herët. Kërkesës duhet t'i bashkëngjitet arsyeja me shkrim, dhe për këtë vendos Komesari i garave.

Neni 16

Eshtë obligim i Komesarit të përgatis orarin e garave dhe t'i njoftoj klubet pjesëmarrëse të garave në Ligë. Orari i garave publikohet në zyrat e FSPK-ës, dhe klubeve duhet t'u dërgohet me postë elektronike (e-mail). Të gjitha klubet janë të obliguara ta vërtetojnë pranimin.

Neni 17

Komesari i garave mund të shtyjë zhvillimin e një ndeshje apo të komplet xhiros (javës) së caktuar, pa kërkesë të ekipeve vetëm në këto raste:

- Fatkeqësisë elementare, ndalesës së organeve shtetërore, shëndetësore apo organeve lokale;
- Në rastet e helmimit apo të sëmundjeve të më shumë se pesë (5) lojtarëve standard, duke dëshmuar me raportin mjekësor të vërtetuar nga Enti përkatës shëndetësor;
- Pjesëmarrjes së dy apo më tepër lojtarëve në Repreracionin e Federatës;
- Pjesëmarrjes së ekipeve në gara të kupave të ndryshme ndërkombëtare që mund të organizohen nga sektorë të caktuar të vendeve të ndryshme, në të cilat do të marrin pjesë klubet e FSPK-ës.

Neni 18

Rreptësishtë duhet të respektohet koha e fillimit të ndeshjes. Cdo vonesë e ekipit, gjyqtarëve apo personave tjerë zyrtarë, evidentuesi/procesmbajtësi, është i obliguar t'i konstatoi në protokoll të ndeshjes.

Koha e pritjes së ekipit kundërshtar për zhvillim të lojës, është 15 minuta.

Evidentuesi, në raste të caktuara, me pëlqim të ekipit tjetër, mund të shtyjë kohën e pritjes së ekipit kundërshtar për më së shumti 30 minuta. Të gjitha këto të dhëna duhet të shënohen në procesverbal të ndeshjes.



FEDERATA SPORTIVE E PUNËTORËVE TË KOSOVËS

Neni 19

Komesari i garave obligohet të ndërmarrë masa që ndeshjet e shtyra, të zhvillohen para zhvillimit të xhiros së fundit të kampionatit të rregullt. Nëse për ndonjë arsye objektive ato nuk mund të zhvillohen, KG është i obliguar të shtyjë zhvillimin e garave të xhiros së fundit, derisa të zhvillohen ndeshjet e mbetura, por jo më shumë se për një javë. Nëse edhe brenda asaj periudhe nuk arrihet të zhvillohen ndeshjet e mbetura, ato ndeshje do të regjistrohen me rezultat zyrtar (20:0), në dëm të ekipit që është shkaktar i moszhvillimit të ndeshjes.

Neni 20

Procesverbalet e ndeshjeve plotësohen me dorëshkrim, me shkronja të qarta, në tre ekzemplarë të njëjtë. Origjinali i dorëzohet vëzhguesit/kontrolluesit, ndërsa nga një ekzemplar ekipeve garuese në ndeshje. Të gjitha vërejtjet eventuale, ankesat etj., në formë të shkruar i adresohen Komesarit të garave.

Neni 21

Të gjithë lojtarët e regjistruar për pjesëmarrje në gara, duhet të kenë kontratë pune apo kontratë mbi vepër, me institucionin/kompaninë për të cilën zhvillojnë gara.

Nëse lojtari nuk ka kontratë të punës apo kontratë mbi vepër me institucionin/kompaninë për të cilën zhvillon gara, nuk mund të paraqitet në lojë. Nëse paraqitet, ndeshja regjistrohet me rezultat zyrtar 20:0 për ekipin rival.

Neni 22

Ekipeve pjesëmarrëse në gara paraqiten me ngjyrat e klubit. Kur dy ekipe kanë ngjyrë të njëjtë të fanellave, ekipi mysafir - i dyti gjatë procesit të hudhjes së shortit, obligohet të sigurojë fanella me ngjyrë tjetër.

Neni 23

Të gjitha ekipet janë të obliguara që KG-së, t'i paraqesin ngjyrat e fanellave me të cilat do të zhvillojnë ndeshjet gjatë kampionatit. Ekipet që nuk e kryejnë këtë obligim, obligohen që rregullisht të sigurojnë fanella me ngjyrë tjetër nga ajo që ka ekipi kundërshtar.

Neni 24

Fanellat duhet të kenë numrat në shpinë dhe duhet të jenë të njëjta, të mos ketë laramani. Evidentuesi/procesmbajtësi, para fillimit të ndeshjes, duhet t'i kontrolloi ngjyrat e fanellave të lojtarëve. Ekipi i cili nuk e plotëson kushtin nga alineja 1 e këtij neni, nuk mund të zhvilloj lojën dhe rezultati do të regjistrohet 20:0 në dobi të ekipit kundërshtar.

Neni 25

Federata obligohet të siguroj mjetet e nevojshme për matjen e kohës (semafor-in), topa për zhvillimin e ndeshjeve, pipa, ekzemplarë të nevojshëm të procesverbalit, dhe kushtet tjera për punë dhe lojë normale.

Neni 26

Shpenzimet e personave zyrtarë: gjyqtarë, mjek, vëzhgues, evidentues/procesmbajtës, i paguan Federata.

Neni 27

Të gjitha ekipet, janë të obliguara që para fillimit të Kampionatit, të bëjnë pagesën në emër të kuotizimit.

Pagesa e kuotës duhet të paguhet 7 ditë para fillimit të sezonit garues. Pagesa bëhet në xhirollogari të FSPK-ës. Ekipi i cili nuk e bën pagesën sipas paragrafit të lartcekur nuk mund të zhvilloj garat.

Neni 28

Sekretari i FSPK-ës është i obliguar që para fillimit të ndeshjes së xhiros të parë të Kampionatit, të verifikoj pagesat e bëra të secilit ekip, dhe të njoftoj Komisararin e garave.



FEDERATA SPORTIVE E PUNËTORËVE TË KOSOVËS

Neni 29

Nëse njëra nga ekipet nuk ka bërë pagesën, ndeshja nuk mund të zhvillohet dhe ajo do të regjistrohet me rezultat 20:0 në të mirë të ekipit kundërshtar. Nëse të dy ekipet nuk e kanë paguar kuotën, ndeshja nuk mund të zhvillohet, dhe ekipet do të fitojnë 0 (zero) pikë, dhe evidencohen si ndeshje të pazhvilluara.

Neni 30

Caktimi i personave zyrtarë (gjyqtarë, vëzhgues, evidentues), për cdo ndeshje bëhet nga nga KG-ve. Në tavolinën e gjyqtarisë mund të qëndrojnë vetëm persona zyrtarë, sipas renditjes të përcaktuar në rregullat zyrtare të lojës, ashtu që sipas renditjes, procesmbajtësi gjithnjë duhet të jetë në anën e djathtë të vëzhguesit, dhe:

- Në vendin e parë – matësi i kohës;
- Në vendin e dytë – matësi i 24 sekondëshit;
- Në vendin e tretë – vëzhguesi; dhe
- Në vendin e katërtë – procesmbajtësi.

Gjatë ndeshjes me tavolinën zyrtare mund të kontaktoj vetëm trajneri i skuadrës.

Neni 31

Nëse vëzhguesi nuk është prezent në ndeshje, atë me të gjitha të drejtat dhe obligimet, e zëvendëson gjyqtari i parë i deleguar për ndeshje.

Neni 32

Në raste të përjashtimit të një apo më shumë lojtarëve në ndeshje, evidentuesi është i obliguar që pas përfundimit të ndeshjes t'i marrë deklaratat me shkrim të lojtarëve të përjashtuar.

Deklaratat e lojtarëve duhet të jenë të nënshkruara nga vetë lojtarët e përjashtuar dhe deklaratat e tyre janë pjesë përbërëse e procesverbalit. Nëse vëzhguesi nuk ka mundësi të marrë deklaratën e lojtarëve të përjashtuar, ai është i obliguar që këtë t'a theksojë në procesverbal.

Lojtari apo personi zyrtar i përjashtuar me karton të kuq për shkak të sjelljeve të rënda josportive ndaj personave zyrtarë apo lojtarëve kundërshtar, do të dënohet me 20€, 1-3 ndeshje mos lojë apo mospjesëmarrje në gara. Në rastet e përsëritura, dënimet do të jenë progresive.

Neni 33

Evidentuesi dhe gjyqtarët janë të obliguar që KG-së, më së voni 48 orë pas përfundimit të ndeshjes, t'ia dorëzojnë procesverbalin e ndeshjes.

Nëse evidentuesi nuk e sjell procesverbalin në afat prej 48 orëve pas përfundimit të ndeshjes në zyrën e FSPK-ës apo te KG-ve, nuk do të paguhet dhe do të ndëshkohet me mos-delegim prej 1 deri 3 ndeshje.

Neni 34

Evidentuesi i ndeshjes është i obliguar që më së voni 30 minuta pas përfundimit të ndeshjes, të lajmëroj KG-ve mbi përfundimin e ndeshjes, me rezultatin dhe vlerësimin e çiftit të gjyqtarëve, me anë të mesazhit të shkruar.

Neni 35

Kontrollimi mjekësor i lojtarëve duhet të bëhet 2 herë, para fillimit të pjesës së parë dhe të dytë të garave.

Neni 36

Gjyqtarët duhet të jenë të veshur me uniformën e gjyqtarit dhe janë të obliguar të paraqiten në palestër, së paku 15 minuta para fillimit të ndeshjes. Pas përfundimit të lojës, gjyqtarët largohen nga fusha e lojës, vetëm me pëlqimin e vëzhguesit të ndeshjes.



FEDERATA SPORTIVE E PUNËTORËVE TË KOSOVËS

Në qoftë se njëri ose të dy gjyqtarët nuk paraqiten në ndeshje, vëzhguesi është i autorizuar të caktojë gjyqtarë të tjerë, të cilët gjenden në palestër ose mund të arrijnë në kohë të duhur.

Neni 37

Gjyqtarët janë plotësisht të pavarur në marrjen e vendimeve. Gjatë ndeshjes janë të obliguar t'i zbatojnë rregullat zyrtare të FIBA-së dhe dispozitat e këtyre propozicioneve.

Gjyqtarët janë përgjegjës për mbajtjen e rendit në palestër dhe duhet të bashkëpunojnë me tavolinën e gjyqtarisë. Gjyqtari i parë, para fillimit të ndeshjes e bën kontrollimin e protokollit të ndeshjes, verifikon se a janë të shënuar të gjithë lojtarët me numra të fanellave dhe trajnerët.

Trajnerët, me nënshkrim të protokollit të ndeshjes, vërtetojnë saktësinë e shënimeve të evidentuara në protokollin e ndeshjes.

Gjyqtarët dhe vëzhguesi i ndeshjes, nuk janë të autorizuar të bëjnë ndryshimin e rregullave zyrtare të lojës.

Neni 38

Listën e vëzhguesve e përcakton Komiteti Ekzekutiv i FSPK-së, kurse delegimin e tyre në ndeshje e bën KG-ve.

Vëzhguesi është përgjegjës për punën e tavolinës së gjyqtarisë. Ai ka për detyrë të përcjellë ngjarjen në shikues, rreth tavolinës së gjyqtarisë, bankës së skuadrave dhe në rast nevojë t'i bëjë me dije gjyqtarët, në mënyrë që ata me kohë t'i ndër marrin masat e duhura.

Vëzhguesi obligohet që në raportin e tij të deklarohet rreth ngjarjeve kontestuese dhe të insistojë te gjyqtarët të deklarohen lidhur me vërejtjet e bëra nga skuadrat, me përjashtim të atyre që kanë të bëjnë me gjykimin.

Vëzhguesi është i obliguar që më së largu 30 minuta pas përfundimit të ndeshjes të informoj Komesarin për rezultatin e ndeshjes.

Neni 39

Vëzhguesi, në raport bën fletëparaqitje ndaj personit që ka bërë shkelje disiplinore, merr deklaratën e tij dhe të gjyqtarëve, dhe nëse e vlerëson të arsyeshme edhe të përfaqësuesve zyrtarë të skuadrave dhe të personave tjerë. Nga lojtari, trajneri ose përfaqësuesi zyrtar i përjashtuar nga loja, vëzhguesi e merr deklaratën me shkrim.

Neni 40

Komisari i Garave në bazë të vlerësimit të tij për rëndësinë e ndeshjes, ka të drejtë të delegojë kontrollor të ndeshjes ose këtë detyrë ta kryej vet me prezencën e tij në ndeshje.

Neni 41

Përgjegjësinë disiplinore të vëzhguesit e konstaton dhe mbi të merr vendim Komesari i Garave, në bazë të dispozitave të këtyre propozicioneve.

Neni 42

Vendimin për masat disiplinore ndaj lojtarëve, gjyqtarëve, evidentuesit përkatësisht matësit të kohës, përfaqësuesve të ekipeve etj., në rangun e shkallës së parë, e merr KG-ve, në mbështetje të Rregullores disiplinore të FSPK-së dhe dispozitave të këtyre propozicioneve.

Neni 43

Për ndeshjen e zhvilluar, ekipi ka të drejtë ushtrimi të ankesës. Paraqitja e ankesës bëhet më së voni 30 minuta pas përfundimit të ndeshjes.

Neni 44

Kundër vendimit të KG-ve i cili vendos si organ i shkallës së parë, ekipi, lojtarët, gjyqtarët, evidentuesi dhe personat e tjerë zyrtarë të pakënaqur me vendimin e organit të shkallës së parë, kanë të drejtë ankese organit të shkallës së dytë, KE-së të FSPK-së, në afatin prej 8 ditësh nga dita e regjistrimit në Buletinin e garave.



FEDERATA SPORTIVE E PUNËTORËVE TË KOSOVËS

Neni 45

Ankesa në ndeshjet e garave shtesë (Play-off) i dorëzohet KG-ve në afat prej 12 (dymbëdhjetë) orëve pas përfundimit të ndeshjes. Vendimi mbi ankesën në shkallën e parë merret në afat prej 24 orëve dhe ju dorëzohet palëve me shkrim. Në këtë vendim, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në organin e shkallës së dytë – KE-së të FSPK, në afat prej 36 orëve, i cili vendim do të merret në afat prej 48 orëve.

Neni 46

Të gjitha ndeshjet e zhvilluara, KG-ve i regjistron në afatin prej 48 orëve, në bazë të dhënave që rezultojnë nga dokumentacioni zyrtar (procesverbali i ndeshjes, raportet e gjyqtarëve dhe evidentuesit). Në rast të paraqitjes së ankesës, afati i regjistrimit të ndeshjes shtyhet deri në 7 ditë. Në rastet e jashtëzakonshme kur duhet të mblidhen materialet argumentuese për ndeshjen e ndërprerë ajo mund të shtyhet për regjistrim më së largu 15 ditë.

Neni 47

Nëse njëri ekip jep dorëheqje apo largohet nga garat, ndeshjet regjistrohen me rezultatet e arritura në terren. Ndeshjet e zhvilluara nuk regjistrohen kur ekipi ka zhvilluar më pak se 50% të ndeshjeve, kurse ato do të regjistrohen me rezultat zyrtar 20:0 për ekipin kundërshtar, nëse ekipi ka zhvilluar 50%+ 1 (një) ndeshje.

Neni 48

Komisioni i garave përpilon Buletinin dhe atë e publikon në selinë e FSPK-ës.

Neni 49

Të gjitha ekipet, janë të obliguara që para fillimit të Kampionatit, të bëjnë pagesën në emër të kuotizimit. Lartësia e kuotës është në vlerë prej **800.00 Euro**.

Pagesa e kuotës duhet të paguhet 7 ditë para fillimit të sezonit garues.

Pagesa bëhet në xhirollogarinë e FSPK-ës, të dhënë në faturë.

Ekipi i cili nuk e bënë pagesën sipas paragrafit të lartcekur nuk mund të zhvilloj garat.

Neni 50

Interpretimin e këtyre Propozicioneve e bënë Komiteti Ekzekutiv i FSPK-së.

Neni 51


Ndryshimet dhe plotësimet e këtyre Propozicioneve, bëhen në të njëjtën mënyrë sikur se edhe janë miratuar.

Neni 52

Këto Propozicione hyjnë në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi dhe aplikohen për vitin garues 2023.

Prishtinë, 24/04/2023




Ismail SADIKU, Kryetar